

2009

Presidenca Suedeze me UE-në
Pritjet për Ballkanin perëndimor



se2009.eu

Analytica

7/30/2009

Më 1 Korrik 2009, Suedia trashëgon timonin e UE-së nga Çekia për gjashtë muajt e ardhshëm. Njëjtë si agjendat e shteteve tjera të UE-së, ashtu edhe agjenda suedeze për keta gjashtë muajt reflekton interesat e saj më të rëndësishme. Kjo është shumë e rëndësishme për shod shtet që udhëheq me UE-në pasi që presidenca luan rol vendimtar në organizimin e punës së Këshillit të UE-së dhe shërben si fuqi lëvizëse për promovimin e agjendës së tyre si dhe për udhëheqjen me procesin legjislativ dhe marrjes së vendimeve.

Marrë në përgjithësi, vendet e Ballkanit perëndimor janë të interesuara për presidencën rrotacionuese pasi që promovimi i interesave të tyre varet nga ajo se cili shtet është në krye të UE-së për ata gjashtë muajt si dhe nga dhe prirjet e shtetit kryesues për zgjerimin e UE-së. Nëse zgjerimi i Unionit qëndron lartë në agjendë, atëherë pritjet që ai të ecë përpara me shpejtësi më të madhe. Vendi kryesues me UE-në mund gjithashtu të ndihmojë në ndërmjetësimin e çështjeve të hapura lokale dhe rajonale që paraqiten si ngadalësues të procesit të zgjerimit. Si do të zhvillohen marrëdhëniet ndërmjet vendit kryesues dhe Ballkanit perëndimor mvaret para së gjithash nga interesat që ai shtet ka në rajon ose me çdo shtet veç e veç. Në këtë kontekst, ky raport para së gjithash analizon agjendën e kryesimit të Suedisë me UE-në si dhe prioritetet e saj që do mundohet t'i çojë përpara. Më tej, raporti fokusohet në secilin nga shtetet e Ballkanit perëndimor veçmas.

Sfidat më të mëdha me të cilat do të ballafaqohet Presidenca suedeze në gjashtë muajt e ardhshëm janë traktati i Lisabonit dhe ratifikimi i mëtutjeshëm i tij, kriza ekonomike botërore, ndryshimet klimatike si dhe implementimi i “Programit të Stokholmit”.¹

¹ Në mbledhjen e Samitit evropian të 5 Nëntorit 2004 hyri në fuqi plani pesëvjeçar për bashkëpunim në gjyqësi dhe punë të brendshme. Plani, i njohur si Programi i Hagës, përfshin bashkëpunim policor dhe doganor, operacione shpëtuese, bashkëpunimet në të drejtën civile dhe penale, azilin, migracionin, vizat dhe kontrollin e kufijve të jashtëm. Plani i parë strategjik akcional në fushën e gjyqësisë dhe punëve të brendshme u ratifikua në Trampere në vitin 1999. Plani i tanishëm, i ratifikuar në nëntor të vitit 2004, ka afat deri në dhjetor të vitit 2009. Krijimi i udhëzimeve të reja për punë të mëtutjeshme në formë të një plani akcional – Programi i Stokholmit do të jetë detyrë kryesore e bisedimeve gjate Presidencës Suedeze. Më 25 shtator 2008, Komisioni evropian promovoi debatin publik për bashkëpunim të mëtutjeshëm i cili përfshin vendet anëtare të Unionit, parlamentet kombëtare, publikun e gjerë dhe palë tjera të interesuara. Komisioni publikoi komunikatë për ardhmërinë e programit në Maj të vitit 2009. Programi u diskutua në mbledhjen joformale të Këshillit për punë të brendshme të përbashkëta në Stokholm në Korrik të vitit 2009 dhe do të ratifikohet në Samitin që do të mbahet në dhjetor të vitit 2009. Rezultatet e programit do të kenë ndikim në

Në prezentimin e agjendës së Suedisë para Parlamentit Evropian, kryeministri suedez Fredrik Reinfeldt u fokusua në ndryshimet klimatike dhe përparësitë në ndërmarrjen e masave konkrete në këtë fushë, krizën ekonomike, kontrollin mbi tregjet financiare, deficitet e mëdha buxhetore dhe si pikë kryesore nënkuptohet në “Programin e Stokholmit”.

Si pasojë e asaj që Suedia gjithmonë ka qenë pioner në gjetjen e zgjidhjeve ekologjike inovative dhe të përmbajtshme, kjo presidencë ia solli mundësinë për të promovuar llojin e shtetit “Eko” në UE. Marrëveshja e re që do të zëvendësojë Protokollin Kjoto bashkë me planin për revitalizim të detit Baltik janë prioritetet që qëndrojnë lartë në agjendën e Suedisë. Megjithatë, probleme tjera siç është ratifikimi i traktatit të Lisabonit mund të largojë vëmendjen nga eko-plani suedez. Kjo presidencë mund të shënojë fundin e një ere nëse traktati i Lisabonit, i dizajnuar për të trajektuar dhe shpjeguar rolet e institucioneve të UE-së, të jetë i ratifikuar nga të gjitha vendet anëtare deri në fund të vitit. Referendumi i dytë për ratifikim të traktatit të Lisabonit është caktuar për në tetor të vitit 2009 në Irlandë. Vlen të theksohet që referendumi i parë dështoi me çka u pengau ratifikimi i mëtutjeshëm. Nëse ky referendum do të ketë epilog pozitiv, atëherë brenda një afati të shkurtë kohor do të ratifikohet edhe nga vendet tjera anëtare të cilat nuk e kanë ratifikuar ende, me çka strukturat institucionale do të hapin portën e zgjerimit të mëtutjeshëm të UE-së.

Qëndrimi suedez mbi çështjen e krizës ekonomike është se UE-ja duhet të gjejë mënyrë për dalje nga kriza përmes inicimit të disiplinës së fortë buxhetore dhe rendit në finansat publike. Për tejkalim të kësaj krize dhe zvogëlimit të normës së papunësisë, Suedia në vend të masave proteccioniste do mundohet që të çojë përpara politikën e hapjes së tregjeve evropiane dhe krijimin e një levizjeje të lirë punëtorësh sa më masive.

Prioriteti i tretë i ashtuquajtur Programi i Stokholmit për politikë të përbashkët migracioni në UE, është i Lidhur me atë që u tha më sipër. Me masat e propozuara në të, do të mundësohet lëvizje e lirë e njërvëzve dhe to të krijohet Sistemi i përbashkët evropian i azilit. Pozicioni i

Suedisë mbi këtë çështje është se “Evropa ka nevojë për fuqi të freskët punëtore përkundër krizës ekonomike dhe normës së lartë të papunësisë”.

Prioritet tjetër në agjendë është roli që UE-ja ka në skenën botërore. Në këtë kontekst, Suedia i ndjek hapat e tanishëm të UE-së të cilët janë: involvim më i lartë në ndodhitë në Afganistan dhe Pakistan, vazhdimi i procesit paqëruajtës në Lindjen e afërt dhe ndihmat ndaj Afrikës për gjetje të zgjidhjeve të krizave të atjeshme.

Prioritetet e presidencës suedeze që u përmendën më lartë, bënë të ditur që Ballkani perëndimor (BP) nuk qëndron lartë në agjendë. Përveç sukseseve të procesit të liberalizimit të vizave, i filluar kohë më parë, kjo presidencë nuk do të tregojë involvim më të madh në procesin e zgjerimit. Megjithatë, vlen të përmendet se Suedia mbetet mbështetës i fortë i procesit të kyçjes së shteteve të BP gjersa këta të fundit plotësojnë kushtet e parashtruara nga UE-ja. Në agjendën e prezentuar përmendet vetëm Kroacia dhe ajo se këtë vjeshtë mund të hyjë në fazën përfundimtare të bisedimeve me UE-në. Për vendet tjera, të quajtura si Ballkani perëndimor, theksohet se presidenca do të punojë në progresin e tyre të mëtutjeshëm në përafrimin me UE-në, por që gjithçka do të varet nga reformat e bëra nga secili shtet në veçanti. Suedia gjithashtu përkrah kyçjen e Turqisë në UE dhe dëshiron që bisedimet për çdo kapitull të vazhdojnë edhe pse që nga gjysma e parë e vitit 2009 kur Çekia qëndronte në krye të UE-së nuk është regjistruar asnjë progres. Pasiqë Franca dhe Gjermania e jetësuan “partneritetin e privilegjuar” në vend të antarësimit të plotë për Turqinë, Suedia është e detyruar të balancojë ndërmjet ripërtëritjes së momentumit në bisedimet për antarësim dhe rrezikut për të krijuar lëkundje politike të cilat do të pengonin realizimin e prioriteteve tjera të agjendës.

Nga ana tjetër, atë që vendet e Ballkanit perëndimor duhet ta kenë parasysh është që Suedia kundërshton intervenimet e UE-së në zgjidhjen e problemeve lokale dhe rajonale dhe si pasojë nuk duhet të shpresojnë në zgjidhje të shpejtë të tyre. Në këtë kontekst, Karl Bidt, Ministri suedez i punëve të jashtme, deklaroi se UE-ja nuk do të involvohet në çështjet rajonale ndërmjet vendeve antare të saj dhe atyre që aspirojnë të antarësohen (Greqia dhe Maqedonia, Sllovenia

dhe Kroacia).² Këtë e vërtetuan edhe zyrtarë tjerë suedezë duke potencuar se problemet rajonale nuk mund të keqpërdoren në procesin e zgjerimit.³

Çka mund të presin vendet e Ballkanit perëndimor nga Presidenca suedeze me UE-ne gjatë muajve vijues?

Maqedonia – në fillim të korrikut të vitit 2009 morri dritë jeshile për liberalizim të vizave nga Komisioni. Komisioni evropian dy herë bëri vlerësime të progresit të pesë shteteve nga Ballkani perëndimor (një raport në nëntor të vitit 2008 dhe një më 18 maj 2009) në të cilët u dhanë përfunimet vijuese – në bazë të vlerësimeve të ekspertëve të bëra deri tani në fushën e sigurisë së dokumenteve, kontrollit të kufijve, menaxhimit të migracionit dhe sigurisë – Maqedonia i plotëson kushtet për regjim të lirë vizash,⁴ Para se t’u mundësohet qytetarëve udhëtim i lirë pa viza, Këshilli i evropës duhet që të ratifikojë rekomandimin e Komisionit, gjë që pritet të ndodhë në fund të vitit 2009.

Hapi i ardhshëm është padyshim data e shumëpritur e fillimit të bisedimeve për antarësi të plotë në UE. Zyrtarët maqedonas janë optimist së këtë vjeshtë, pas katër viteve të kaluara në pritje, vendi përfundimisht do të shpërblehet me datë për fillim të bisedimeve.

Në këtë kontekst, ambasadori suedez në Maqedoni, z. Lars Freden, deklaroi për mediat se shanset për marrje të datës për bisedime janë të mira. Megjithatë, a do të ndodhë kjo ose jo, nuk varet nga presidenca suedeze por nga EK⁵ dhe qeveria e Maqedonisë e cila është përgjegjëse për përmbushje të kushteve të parashtruara nga UE-ja në marsin e vitit të kaluar.

Kroacia – pritet që bisedimet të vazhdojnë këtë vjeshtë. Por, kontesti bilateral që ka me Slloveninë rreth pjesës së kufirit që shtrihet kah deti Adriatik mund që të prolongojë këtë proces edhe më shumë. Në vitin 2008, 26 vende antare të UE-së dhe KE-së kërkuan që të hapen 10

² “Suedia nuk e ka Ballkani Perëndimor ne agjende”, Tatjana Grncarovska, Utrinski Vesnik, <http://utrinski.com.mk/?ItemID=5D1397CA78F7974EB429FAC73B8A715F>

³ Paul Beyer, Ambasadori suedez ne Sofje Makfax, <http://makfax.com.mk/mk-mk/Details.aspx?itemID=6285>

⁴ Scorecard – Schengen White List Conditions, European Stability Initiative, 22nd of May 2009, page 2.

⁵ Intervju ne A1 lajme, <http://a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=111661>

kapituj të ri nga *acquis* në bisedimet me Kroacinë. Përkundër kësaj, Suedia vendosi veto në nëntë nga dhjetë kapitujt e propozuar. Nga ai moment tensionet në relacionet Lubljanë-Zagreb bënë që UE-ja të angazhojë diplomatin e njohur Marti Ahtisari për të gjetur zgjidhjen e këtij kontesti. Mbetet të shihet nëse Kroacia do të arrijë të vazhdojë negociatat gjatë presidencës suedeze me UE-në, duke pasur parasysh faktin që zyrtarët suedez nuk duan të involvohen në konteste të tilla rajonale.

Serbia – njejtë si rasti i Maqedonisë, edhe Serbia hyri në grupin e shteteve që pritet të marrin regjim të lirë vizash nga 1 janari i vitit 2010. Raporti I Komisionit për Serbinë theksonte se Serbia plotëson një numër të madh të kushteve të parashtruara për udhëtim pa viza dhe si pasojë e përparimit impresionues të shënuar, KE vendosi që ta shpërblejë me regjim pa viza. Megjithatë, potencohet se Serbia duhet patjetër të punojë për të plotësuar kriteret e mbetura deri në fund të vitit. Për sa u përket ndodhive tjera, pritet që Serbia të vazhdojë reformat e rrugës për në UE, më një pengesë të vetme – çështja e Kosovës. Për periudhën vijuese, gjatë presidencës së Suedisë me UE-në nuk pritet ndonjë përparim i madh në atë fushë.

Mali i Zi – morri të njejtat vëretje si Serbia lidhur me liberalizimin e vizave dhe me këtë hyri në grupin e vendeve të cilave u është rekomanduar regjim pa viza. Mali i Zi parashtrroi aplikacionin për antarësim në UE më 15 Dhjetor, 2008 ndërsa më 23 Prill 2009, Këshilli kërkoi nga Komisioni që të japë mendim për aplikacionin e parashtruar. Edhe pse herët, pritet që në vjeshtë Komisioni të jep mendimin e tij për aplikacionin, por me të vetmin kusht që Mali i Zi të arrijë të hapë pyetësonin e KE në kohë.

Bosnja dhe Hercegovina – është në grupin e vendeve të cilat nuk i kanë përmbushur kushtet e parashtruara nga Komisioni Evropian për marrje të regjimit pa viza. BH megjithatë u stimulua që të vazhdojë me përpjekjet për përmbushje të kriterëve të vendosura edhe vitin tjetër. Në muajt që vijojnë, nuk priten ndodhi më të mëdha rreth përparimit të BH në rrugën drejt UE-së.

Shqipëria – është në të njejtën pozitë si Bosnja dhe Hercegovina kur bëhet fjalë për liberalizimin e vizave. Më 28 Prill, 2009, Shqipëria parashtrroi aplikacionin e saj për antarësim në UE. Këshilli i Evropës ende është duke e shqyrtuar aplikacionin e dërguar dhe ende nuk ka kërkuar nga

Komisioni që të japë mendim lidhur me këtë. Kjo çështje nuk do të jetë pjesë e raportit të KE-së për vitin 2009 andaj nuk priten ndryshime më të mëdha gjatë presidencës suedeze.

Kosova – “Shteti i gjashtë ballkanik, qytetarët e të cilit janë të detyruar të marrin vizë kur udhëtojnë në BE, nuk është i përfshirë në procesin e liberalizimit të vizave dhe rrezikon të mbetet enklavë e lënë anash rajoni,⁶ Kjo është një pyetje shumë problematike jo vetëm në aspekt të Kosovës por edhe në aspektin serb, pasi që siç dihet i tërë Unioni ka përgjegjësi ndaj Kosovës. “Nuk është e qartë pse UE-ja dëshiron të lëshojë shansin që përmes një instrumenti të fortë si ky të shënojë përparim në ruajtjen e rendit dhe paqes, kontrollit kufitar dhe sundimit të ligjit,⁷

Fakti që Ballkani perëndimor nuk qëndron lartë në agjendën suedeze si dhe situata aktuale e komplikuar në Kosovë, nuk lënë hapësirë për të pritur ndryshime të theksuara për këtë çështje në muajt në vijim.

Presidenca suedeze me Unionin Evropian solli një gjë shumë pozitive për Ballkanin perëndimor: “dritën jeshile,, nga Komisioni për të hequr regjimin e vizave për Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi. Shqipëria dhe Bosnja dhe Hercegovina ishin të inkurajuar të vazhdojnë me reformat në këtë fushë. Përkundër kësaj, analiza në këtë raport të shkurtë tregoi se Presidenca suedeze nuk do të sjellë zhvillime më të rëndësishme në raport me shtetet e Ballkanit perëndimor. Agjenda suedeze është përplot me prioritete tjera si: kriza botërore ekonomike, ratifikimi i traktatit të Lisabonit dhe me këtë problemet dhe pritjet e Ballkanit perëndimor janë lënë anash. Suedia megjithatë mbetet ende përkrahës i fortë i procesit të zgjerimit por kjo nuk përfshin involvim në zgjidhjen e problemeve rajonale që pengojnë këtë process. Suedia gjithashtu pret që BP të vazhdojë në rrugën e reformave dhe t’i plotësojë standardet e kërkuara nga UE-ja. Mesazhi për vendet e Ballkanit Perëndimor mbetet i njëjtë edhe në këtë rast: të arrihen reformat e duhura para shpalljes së raporteve vjetore të Komisionit në nëntor dhe pranimi i faktit që këto reforma dhe standarde nuk janë vetëm kushte për hyrje në UE por edhe mënyrë përmes implementimit të të cilave stimulohet zhvillimi i shtetit dhe shoqërisë.

⁶ Scorecard – Schengen White List Conditions, page 2.

⁷ Ibid., page 2.

EU Approximation and Integration Advocacy Program

“Presidenca Suedeze me UE-në – Pritjet për Ballkanin perëndimor ”

Sonja Risteska, Hulumtuese e programit
sristeska@analyticamk.org

Publikimi i ardhshëm:

Katër vite nga Statusi i vendit kandidat: Çka është bërë dhe cilat janë pritjet?

Analytica

Web: www.analyticamk.org
Email: info@analyticamk.org

Dame Gruev No: 7-8/3
1000 Skopje, Macedonia
Phone: 00 389 (0)2 3121 948
Fax: 00 389 (0)2 3121 948
